

Përmirësimi i notave

- 1.** Studenti ka të drejtë të kërkoj përmirësimin e notës. Një veprim i tillë lejohet kur nota që kërkon të përmirësoj studenti është e një lënde të vitit akademik që ai sapo ka mbyllur. Studenti ka të drejtë të përmirësoj deri në dy nota në vit.
- 2.** Për përmirësimin e notës, studenti provohet vetëm një herë dhe vetëm në sesionin e vjeshtës. Mbetet në fuqi nota me të cilën studenti vlerësohet në fund. Në rast se studenti nuk paraqitet, mbetet në fuqi nota e sesionit të mëparshëm.
- 3.** Kërkesa për përmirësim note i paraqitet dekanit jo më vonë se një javë pas përfundimit të sesionit të verës. Në bazë të vendimit që merr dekani, sekretaria mësimore kryen veprimet përkatëse.
- 4.** Studenti mund të përmirësojë vetëm vlerësimin e marrë në provim, i cili i bashkëngjitet vlerësimin të marrë në elementët e tjerë të lëndës përgjatë vitit shkollor.
- 5.** Në rastin e organizimit të moduleve të përbërë ku marrin pjesë disa disiplina, ku vlerësimi realizohet nëpërmjet provimeve të integruara, ose shlyrjes së modulit me pjesë, përmirësimi i notës bëhet për të gjithë lëndën.